



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.566/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Faton Ademi, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e Anton Shala, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.566/2021, i Anton Shala, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për kandidatin për anëtar të Kuvendit Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë në Vendvotimin: 0804C/02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Kryesuesit të Vendvotimit 0804C/02R Ferdinand Gojani me nr. të letërnjoftimit 1240930729, si dhe anëtarëve të këtij vendvotimi Ardian Ramuni me nr. të letërnjoftimit 1241629224, Gustin Tomaj me nr. të letërnjoftimit 1002650866, Ardita Balaj me nr. të letërnjoftimit 1244313457, Paulin Zefaj me nr. të letërnjoftimit 1230896212, Muhamet Haradini me nr. të letërnjoftimit 2171362647, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.03.2021, nga Anton Shala, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se pas marrjes së rezultateve në Shkollën “Shtjefen Gjeçovi” në Zllakuqan Komuna e Klinës, në

qendrën e votimit 0804C/02R, rezultatet e FRP-së në qendër të votimit ka ndërhyrje të mëpastajshme, përkatësisht përmirësim mbi numrin 052 në numër 000. Parashtruesi i apelit pretendon se rezultati për nr.19 në këtë vendvotim është 52, ndërkaq pasi që është ndërhy mbi këtë shifër del se kandidati nuk ka asnjë vote në këtë klasë, pra kandidati është dëmtuar me 52 vota. Më tej ka cekur emrat e disa dëshmitarëve si dhe provën materiale si kopjen e formularit të publikuar në faqe të KQZ-së dhe fletë plotësimin e koordinatorit të shkollës në këtë vend votim.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2021, të KQZ-së, ndër të tjera thekson se Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me ankesën Anr.566/2021, njofton se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin, e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevant. Në bazë të Rregullës Zgjedhore, Nr.06/2013, secili formular i rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Nga auditimi që i është bërë formularëve të rezultateve, rezulton se ka pasur probleme, të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve. Kur krahasohet me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota, por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota. Procedura në QNR, nuk lejon asnjë Formular të kaloj, nëse nuk përputhet me votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota atëherë formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, me datë 04.03.2021, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutinë e Votimit 0804C/02R konstaton se në formularin e rezultateve për kandidatë FRK, kandidati me nr.19 Anton Shala ka zero (0) vota, ndërsa pas numërimit të votave në fletëvotimeve, kandidati Anton Shala ka gjithsej 51 vota të vlefshme dhe një (1) fletëvotim është i pavlefshëm.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Klinë për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit dhe anëtarëve të vendvotimit të cilët janë nënshkruar në FRK, për pjesëmarrje në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kjo është marrë në bazë të nenit 120 par. 3, pika d) i LZP-së. Përgjegjësia e Kryesuesit rrjedh nga fakti se kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par. 10 të LZP-së, ndërsa përgjegjësia e anëtarëve që kanë nënshkruar FRK me shkeljet e evidentuara më lart rrjedh nga fakti i dhënies së pëlqimit me veprim konkludent, me vendosje të nënshkrimit. Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë dhe anëtarët kanë bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesë nuk i janë paraqitur fletëvotimet në FRK ashtu si ishin në kutinë e votimit dhe kjo nënkuptohet si devijim i vullnetit të votuesve.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 566/2021 më datën 05.03.2021

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.